

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ndërtim i linjës së re 110 kV Gjiri i Lalzit – Fushë Kuqe”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31321000-2 - Linja të energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT:

328,680,208 (treqind e njëzet e tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e tetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 300,000,000 (treqind milion) Lekë.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kerkesa e mesiperme eshte ne perpjestim dhe e lidhur ngushte me objektin e kontrates. Duke marre ne konsiderate sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomiko - financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros duhet te jete ne masen 300,000,000 (treqind milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 150,000,000 (njëqind e pesëdhjetë milion) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 600,000,000 (gjashtëqind milion) lekë.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shenim: Kontrata të ngjashme persa i perket punimeve elektrike per vete specifiken qe kane, do te kosiderohen punimet ne Linjat elektrike me nivel tensioni \geq 110 kV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kerkuara, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete sipas parashikimeve ligjore. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Gjithashtu, duke patur ne vemendje punen e veshtire dhe llojin e vecante qe duhet te beje OE ne realizimin e kesaj kontrate, AK kerkon me doemos qe OE ofertues t'a kete nje pervoje te ngjashme te kesaj natyre.

Përsa i përket cilësimit të kontratave të ngjashme, sipas opinionit teknik të inxhinierëve të AK gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, sqarojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. administron rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me tension 110-400 kV, që përbëhet nga nënstacionet 400/220 kV, nënstacione 110/TM kV dhe linjat 110/220/400 kV.

Për të garantuar funksionimin normal dhe të sigurtë të sistemit elektro-energjetik, OST sh.a. ka për detyrë zhvillimin, automatizimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen e komponentëve të Sistemit të Transmetimit.

Theksojmë se, OST sh.a. është institucioni i vetëm menaxhues i objekteve me këto nivele tensioni.

Garantimi i qëndrueshmërisë të Sistemit Energjitik si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike në tensionet e larta bazohet në zbatimin e rreptë të rregulloreve të Sigurimit Teknik dhe të Shfrytëzimit Teknik të Nënstacioneve dhe Linjave të Sistemit Energjitik.

Për të bërë një krahasim të nivelit teknik/profesional të kërkuar në punimet në pajisjet e tensionit të lartë argumentojme si vijon për punimet me nivel tension 110, 220 dhe 400 kV:

- Rrjetet 110, 220 dhe 400 kV, administruar nga OST sh.a. janë të ndërtuar në ajër (AIS) pra, përdorin qëndrueshmëri elektrike të ajrit si material izolues. Ato kërkojnë sipërfaqe të madhe dhe në shumë raste punime në hapësira që janë afër pajisjeve nën tension të lartë që paraqesin rrezikshmëri të lartë për operatorët. Puna e tyre mbikëqyret dhe kushtëzohet nga kërkesat e rregulloreve të sipërpërmendura. Në nënstacion/linja mund të punojnë vetëm operatorë të instruktuar dhe me kartelë të sigurimit teknik.
 - Pajisjet primare vendosen në bazamente betoni të armuar dhe konstruksione mekanike të veçanta. Theksojmë që pajisjet primare janë të rënda dhe njëkohësisht tepër delikate. Ato kërkojnë makina ngritese/transportuese si dhe rrespektimin e rregullave të veçanta për transportin, lëvizjen, vendosjen në bazament dhe montimin.
 - Punimet për kabllimin, testimin, komisionimin e tyre, të cilat kryhen për secilin element kanë nevojë për operatorë shumë të specializuar për shkak të vështirësive, kompleksitetit të punimeve dhe kanë një kosto relativisht të madhe.
 - Mbrojtja rele është një pajisje komplekse që shfrytëzon të dhëna të kombinuara (rryme/tension) dhe mbrojtje rryme, të cilat kablohen duke krijuar llogjika për bllokime elektrike për mosveprim në rast veprimesh të gabuara. Mbrojtjet rele dhe automatika (BCU) vendosen në panele të veçanta.
 - Për testimin dhe komisionimin e saj ndiqet një procedurë e standardizuar IEC. Kompleksiteti i punës në to kërkon gjithashtu punonjës me specializim të lartë dhe njohuri të thella për pajisjet.
 - Matja vendoset në panele të veçantë dhe ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të rrepta IEC. Operatorët janë tepër të specializuar.
 - Në një nënstacion bëhen punime për SKADEN dhe Telekomunikacionin që kërkojnë njohje të pajisjeve dhe specializim të lartë të operatorëve dhe kompanive që punojnë.
 - Punimet për ndërtimin/rikonstruksionin/punimet e linjave të tensionit të lartë kanë vështirësi që lidhen me projektimin, ndërtimin, vendosjen e shtyllave, përcjellësve dhe elementeve të ndryshëm përbërës të saj. Ndërtimi i një linje të tensionit të lartë kërkon makina dhe pajisje speciale pa të cilat kompromentohet seriozisht cilësia e punimeve për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i linjave të tensionit të lartë kërkon kushte teknike të veçanta dhe shumë të rrepta pasi ato ju nënshtrohen kushteve atmosferike tepër të rënda dhe duhet të paraqesin qëndrueshmëri të mjaftueshme mekanike ndaj tyre.
-

- Mund të pohojmë se, kompleksiteti, vështirësia dhe rëndësia e punimeve të sipërpërmendura rritet me rritjen e nivelit i tensionit (ndryshimi mes 110, 220 dhe 400 kV dhe niveleve të tjera më të ulëta të tensionit) dhe përcakton në mënyrë domethënëse edhe kërkesat për nivelin profesional të operatorëve që do ti kryejnë ato si dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve.

Theksojmë se: në përcaktimin e kushteve për punime në objektet e OST sh.a., përveç rregulloreve tona, është marrë si model edhe procedura dhe kërkesat teknike të ndjekura nga Kontraktorë të huaj shumë të njohur dhe me eksperiencë që kanë punuar në objektet tona prej më shumë se 15 vite.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale ne fushen e projektimit ose te kete marrveshje kontraktuale me disponuesit e ketyre licencave, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorit e meposhtme:

<i>Projektues konstruktor</i>	- Pika 3/a,b
<i>Projektues instalator</i>	- Pika 4/c
<i>Proejktues elektronik/telekomunikacion</i>	- Pika 4/j
<i>Projektim impianteve ... te shpernd. en. elektrike</i>	- Pika 10/d

Argumentimi: Keto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktoje disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues ose personi fizik apo juridik qe disponon licencat e projektimit dhe qe ka marrveshje kontraktuale me ofertuesin per realizimin e projektit, duhet te disponoje: Program te licencuar “PLS CADD and TOWER” ose te ngjashem.

Argumentimi: Kjo kërkesë është e domosdoshme pasi OST disponon licencat dhe përdor për projektimin e linjave softin *PLS CADD and TOWER*. Në mënyrë që të analizohet projekti i hartuar nga kontraktori përveç dokumentacionit me ralcionin e printuar nevojitet dhe një kopje elektronike e projektit në CD. Kjo do të jetë në formatin “.bak” dhe me pas do të ekstrahohet nga stafi teknik i OST për të kontrolluar projektin e linjes e paraqitur për aprovim, llogaritjet e shtyllave ngarkesat mekanike dhe kriteret me koeficientet e sigurisë së aplikuar.

Gjithashtu në mënyrë që të mos ketë kufizim tregu në ofertim është lënë mundësia dhe për aplikacione të tjera të ngjashme mjafton që kopja elektronike e projektit të jetë në formatin “.bak” file në mënyrë që projekti të jetë i lexueshëm nga softet e instaluar në kompjuterat e OST sh.a.

Por eshte e domosdoshme qe nje operatori ekonomik ose personi qe do te hatoje projektin te kete nje licencim ose trajnim personal qe deshmon kapacitet teknike dhe aftesine ne perdorimin e ketij softi apo softeve ekuivalente.

Me ane te softit PLS CADD ndertohet profili gjatesor, llogariten varjet e percjellesit, , sidhe nxirren ngarkesat ne strukturen e shtyllave nga percjellesit .

Ky është një kriter i nevojshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me suksese të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky aplikacion sherben dhe eshte i lidhur ngushtesisht me realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi. Ky aplikacion nuk e kufizon konkurrencen per shkak se mund te blihet lehtesisht nga çdo OE ofertues.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:*

Punime te pergjithshme/speciale ndertimi:

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi ne toke</i>	<i>Klasifikimi B</i>
<i>Kategoria NP-2</i>	<i>Ndertime civile dhe industriale</i>	<i>Klasifikimi B</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndertime per N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesme dhe shperndarjen e energjise</i>	<i>Klasifikimi E</i>
<i>Kategoria NP-12</i>	<i>Punime te inxhinierise se mjedisit</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-1</i>	<i>Punime per prishjen e ndertimieve</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-8</i>	<i>Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri</i>	<i>Klasifikimi B</i>
<i>Kategoria NS-13</i>	<i>Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Klasifikimi A</i>

Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.

Argumentimi: Kjo kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si vijon:*

- *Si drejtues teknik, te perfshire ne licencen e zbatimit te shoqerise, te pakten 2 (dy) inxhinier elektrik, 2 (dy) inxhinier ndertimi, 2 (dy) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier elektronik, 1 (nje) inxhinier mjedisi, 1 (nje) inxhinier topograf/ gjeodet dhe 1 (nje) inxhinier gjeolog.*
- *Gjithashtu, si pjese e stafit te tij, pervec punonjesve te mesiperm, ofertuesi duket te kete te pakten edhe 1 (nje) inxhinier ndertimi.*

Punonjesit e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinieriët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te dëshmoje se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 50 (pesedhjete) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet te jene te siguruar te pakten për 12 (dymbedhjete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat perkatese E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e puneve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është

proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është perlogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të linjes objekt punimi, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 25 (njetzet e pesë) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, nga të cilët 10 (dhjetë) të jenë punonjes me kategorinë e sigurimit teknik IV-V, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.*

Lidhur me këto pike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- i. Listpagesat E-Sig të punonjesve të sipërcituar, si dhe*
- ii. Kartelat përkatëse të vlefshme të sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjësit që do të realizojnë këto kontrate, për arsye të natyrës teknike të saj dhe kushteve të punës në linjat e tensionit të lartë, duhet të respektojnë rregulloren e sigurimit teknik elektrik, bazuar në dispozitat ligjore përkatëse për punimet mbi 1000 Volt, në lartësi, me heqje dhe pa heqje tensioni, duke rreptuar largësinë me tensionin nominal të punës për linjat 110 kV e lart.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.8 *Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar ose me kontrate sherbimi, mjekun e shoqerise te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te VKM Nr. 108, date 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për mjekun e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës dhe kushtet e sigurise, percaktuar nga legjislacioni ne fuqi. Kjo kërkesë për kualifikim është në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.9 *Operatori ekonomik (ne baze te Ligjit 10237, dt. 18.02.2010, neni 5, pika 15) per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier) duhet te kete te pakten 1(nje) inxhinier te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me risk te larte, dhenien e ndihmes se pare dhe menaxhim emergjencash, i cili te jete i siguruar te pakten per 12 (dymbedhete) muajt e fundit dhe duhet te jete prezent ne kantier gjate ekzekutimit te punimeve. Certifikata te jete e leshuar nga shoqeri te licencuara nga ministria perkatese.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- i) certifikaten e inxhinierit;*
- ii) licencen e shoqerise e cila ka trajnuar punonjesit e operatorit ekonomik;*
- iii) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Persa i perket kerkeses per nje inxhinier te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me risk te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate

zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.10 *Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e meposhtme per kryerjen e punimeve, me qellim realizimin e objektit te prokurimit:*

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Eskavator me kove	1 cope
2	Fadrome	1 cope
3	Autobetoniere	2 cope
4	Autovinc me kapacitet mbajtes jo me pak se 5 ton	1 cope
5	Kamicina me kapacitet mbajtes mbi 1.5 ton	2 cope
6	Motoarganello	2 cope
7	Vinc tip falkone (pa motoarg.)	2 cope
8	Makineri terheqje-leshuese percj.,tros, opgw	2 sete
9	Prese Hidraulike e moterizuar 120 ton	2 sete
10	Kambalec hidraulik per barabanet e kablllove	2 sete

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

1. *Per mjetet, makinerite dhe pajisjet ne pronesi te paraqitet akti i pronesisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit).*
2. *Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronesisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart.*
3. *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimi.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Mjetet dhe pajisjet teknike te vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit te kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/d, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.11 *Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 10 (dhjete) punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certifikate te punimeve ne lartesi te leshuara nga shoqeri te licencuara nga ministria perkatese, te cilet te jene te siguruar te pakten per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- i. Certifikatat e punonjesve per punimet ne lartesi;*
- ii. Licencen e shoqerise e cila ka trajnuar punonjesit e operatorit ekonomik;*
- iii. Listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me stafin teknik te certifikuar per punime ne lartesi, argumentohet se realizimi i punimeve objekt kontrate kerkon punonjes qe kane aftesite fizike dhe teknike per te punuar ne kushte te veshtira pune, ne shtylla tensioni te larte dhe ne lartesi nga toka.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12 *Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (nje) manovrator te pajisur me kartelee personale te sigurimit teknik, te leshuar nga organet kompetente, i cilit te jete i siguruar te pakten per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates (nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).*

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratori i pajisur me kartelee personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohet nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi.

Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmite e drejtimit te leshuar nga Ministria perkatese.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me punonjesin manovrator te kerkuar, theksojme se ky punonjes duhet te disponohet dhe te kete eksperience te nevojshme per te bere te mundur levizjet brenda kantierit te nderitmit, duke patur ne konsiderate kufizimet e mundshme brenda territorit te kantierit.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.14 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001: e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e kësaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.15 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotesoje saktësisht kolonen me të dhenat teknike të ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura në shtojcën 5 (Specifikimet teknike) të ketyre DT-ve.

Mosplotesimi i sakte është element skualifikimi.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.16 Per listen e mëposhtme të mallrave:

- 1. Shtylla metalike 110 kV – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 2. Percjelles ACSR – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 3. Morseteri – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 4. Denfera – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 5. Tros OPGW – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 6. Celes SF6 110 kV trefazor – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 7. Ndares – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 8. Transformator rryme – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 9. Transformator tensioni – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 10. Shkarkues – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 11. Paneli i mbrojtjes rele – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 12. Paneli i komandimit – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 13. Pajisje telekomunikacionit – sipas Specifikimeve Teknike;*
- 14. Radrizator – sipas Specifikimeve Teknike.*

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese:

1. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*
Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

Argumentimi: Në lidhje me kriterin për listën e mallrave që do të përdoren, nisur nga rëndësia e madhe e projektit dhe funksioni që ato do të kryejnë në realizimin e objektit të kontratës, si dhe nga vlera e tyre, u mendua që ky kriter të mundësojë sigurimin e mallrave cilësore me parametra që plotësohen nga prodhues të certifikuar për menaxhimin e cilësisë së mallrave. Ky kriter është në proporcion me vlerën e kontratës, është jodiskriminues dhe i mundshëm të përmbushet nga cdo operator që ka përvojë në këtë fushë objekt kontrate.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.17 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per punimet objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".